



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"
VLORE
ZYRA PROTOKOLL-ARKIVËS
Nr. 65311 Prot.
Datë: 30.04.2020

Nr. _____ Prot.

Vlorë, më 29.04.2020

VENDIM

Nr. 71, datë 29.04.2020


PËR

ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN DHE ADMINISTRIMIN E PROCESIT MËSIMOR ONLINE NË UV, NË KUSHTET E PANDEMISË COVID 19

Në mbështetje të Urdhrit nr.256 datë 10.04.2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin nr.193 prot., datë 20.03.2020 "Për mbylljen apo kufizimin e lëvizjeve në RSH", i ndryshuar, *email-in* e Zv/Ministrit të MASR-së në datë 20.04.2020, si dhe urdhrin e Rektorit për mësimin *online*, Senati Akademik, në mbledhjen e datës 29.04.2020

VENDOSI:

1. Vijimin e mësimin online (në distancë) përmes platformës Google Classroom ose të tjerave, të propozuara dhe miratuara nga njësitë kryesore dhe bazë, sipas alternativave të transmetimit dhe ndërkomunikimit: PPT, PDF, Google Meet, platformës ZOOM etj. duke respektuar kalendarin e semestrit "Pranver" 2020".
2. Moszhvillimin e provimeve të pjesshme dhe transferimin e këtij vlerësimi tek provimi final. Vlerësimi vjetor i studentëve në provimin final të përlllogarit mbi bazën e *syllabus*-eve.
3. Kryerjen e vlerësimin të vazhduar të parashikuar në planet mësimore (*syllabus*-et përkatëse të lëndëve/moduleve), mbi bazën e vlerësimin të detyrave, testeve, ushtrimeve, pyetjeve, etj. për çdo temë gjatë zhvillimit të orës së mësimin.
4. Zhvillimin në auditor të provimeve finale apo të diplomimit, me praninë fizike të studentit, kundrejt respektimit rigoroz të rregullave shendetësore, në rast se procesi mësimor do të rifillojë brenda datës 30 qershor me vendim të MASR.
5. Zhvillimin në formatin online të provimeve finale apo të diplomimit, konform procedurave elektronike të propozuara nga njësitë bazë dhe të miratuara nga dekanatet, në rast se procesi mësimor në auditor nuk rifillon brenda vitit akademik 2019-2020.
6. Senati Akademik t'i dërgojë MASR shkresë, e cila të legjitimojë mesimin *online*.
7. Zhvillimin *online* të praktikave mësimore në fakultete, nën asistencën dhe kontrollin e pedagogëve përkatës të lëndës sipas vendimarrjes në Dekanat, në varësi të karakteristikave konkrete.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

8. Marrjen e një vendimi në një kohë më të vonë, në varësi të ecures së pandemisë, lidhur me praktikat klinike të FSHP.
9. Dokumentimin elektronik të procesit mësimor *online* nga njësitë bazë dhe kryesore, si dhe ruajtjen/administrimin e tyre konform rregullave të përcaktuara nga dekanatet.
10. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi njësitë bazë, kryesore si dhe të gjitha strukturat ndihësakademike.
11. Ngarkohet Sektori Juridik, Fakulteti i Shëndetit Publik dhe Administratori i UV-së për hartimin e Rregullores "Për respektimin e rregullave të zhvillimit të mësimin dhe provimeve në kushtet e emergjencës Covid-19" me qëllim sigurimin e shëndetit të studentëve, stafit pedagogjik dhe ndihmësakademik".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland ZISI

